



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 5100 Prot.

Tiranë, më 29.03 2017

Lënda: Njoftim

Njoftohen të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit si dhe çdo subjekt tjetër që në përmbushje të detyrës së tij përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik (në vijim "SPE"), se:

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") është në përfundim të procesit të implementimit të projektit për ri-inxhinierimin dhe shtimin e disa funksionaliteteve/shërbimeve në SPE, mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re.

Në këtë kuadër, disa nga përmirësimet dhe ndryshimet në SPE janë:

- Përmirësimi dhe optimizimi i ndërfaqeve për të gjitha rolet në sistem;
- Krijimi i Regjistrimit të Parashikimeve dhe Realizimeve të Prokurimit Publik dhe dërgimi për publikim elektronikisht me anë të SPE;
- Përdorimi i kodeve CPV (Common Procurement Vocabulary) gjatë krijimit të procedurave në sistem;
- Ndryshimi i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimi të Ofertave nga autoriteti kontraktor, në raste konflikti interesi, largimi nga detyra, etj;
- Aksesimi i SPE nga të gjithë llojet e shfletuesve të internetit (Google Chrome, Mozilla Firefox, etj);
- Shtimi në portalin e-albania të shërbimit të abonimit për t'u njoftuar nga sistemi i prokurimit elektronik në rast të publikimit të një tenderi për të cilin përdoruesi ka interes sipas kodeve CPV;
- Ofertimi, njoftimi nëpërmjet smartphones dhe tabletave për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

– Përmirësim i portalit të APP, i cili do të ofrojë mundësinë e kërkimit mbi informacionin e publikuar në portal, në lidhje me procedurat e publikuara, si dhe me regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve, sipas dy mënyrave:

- **Kërkim i thjeshtë**, në këtë lloj metode përdoruesi mund të kërkojë sipas një fushe kërkimi.
- **Kërkim i avancuar**, do të shfaqen disa fusha kërkimi, ku përdoruesi mund të kërkojë sipas secilës prej tyre.

Sa më sipër, APP po ju vë në dijeni se për shkak të punimeve për vendosjen në funksion të SPE me ndryshimet e reja, sistemi do të jetë jashtë funksionit (offline) nga data **31.03.2017, ora 15.00** deri në datën **02.04.2017, ora 24.00**.

Të gjitha procedurat e prokurimit që kanë si datë të zhvillimit të tenderit datat **01.04.2017, 02.04.2017 dhe 03.04.2017 do të shtyhen automatikisht për në datën 04.04.2017, në të njëjtën orë.**

Sa më sipër, APP ju sugjeron të merrni masat paraprake të nevojshme për ecurinë e punës tuaj në sistem para datës **31.03.2017, ora 15.00**.

Për çdo paqartësi dhe informacion shtesë ju lutemi të kontaktoni në adresën elektronike: info.app@app.gov.al.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti